



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI**

Konferenca e Kryetarëve

PROCESVERBAL

Tiranë, më 26.02.2019 ora 09.00

Drejton mbledhjen:

Gramoz Ruçi – Kryetar i Kuvendit

Rendi i ditës:

1. Miratimi i programit 6-javor të punimeve të Kuvendit për periudhën 4 mars – 12 prill 2019.
2. Miratimi i kalendarit 3-javor të punimeve të Kuvendit për periudhën 4 – 22 mars 2019.

Të pranishëm:

Gramoz Ruçi –	Kryetar i Kuvendit
Vasilika Hysi -	Zëvendëskryetare e Kuvendit
Elisa Spiropali –	Ministre për Marrëdhëniet me Parlamentin
Taulant Balla -	Kryetar i Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste
Mimi Kodheli -	Kryetare e Komisionit për Politikën e Jashtme
Niko Peleshi -	Kryetar i Komisionit për Veprimtarinë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin
Ermonela Felaj -	Kryetare e Komisionit për Sigurinë Kombëtare
Arben Ahmetaj -	Kryetar i Komisionit të Ekonomisë dhe Financave
Ulsi Manja -	Kryetar i Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut
Milva Ekonomi -	Zëvendëskryetare e Komisionit për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik
Senida Mesi -	Zëvendëskryetare e Komisionit për Integrimin European
Klodiana Spahiu -	Zëvendëskryetare e Komisionit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shëndetësisë

HAPET MBLEDHJA

Gramoz Ruçi – Hapim mbledhjen e Konferencës së Kryetarëve, ku në rend të ditës kemi miratimin e programit të punës së Kuvendit për periudhën 4 mars – 12 prill 2019 dhe miratimin e kalendarit 3-javor të punimeve të Kuvendit për periudhën 4 – 22 mars 2019.

Me projektprogramin dhe projektkalendarin jeni njohur paraprakisht në rrugë elektronike. Projektprogrami përfshin të gjitha çështjet e depozituara në Kuvend si projektligje, projektvendime, projektrezoluta etj.

Projektkalendari përfshin veprimtarinë në komisione dhe në seancë plenare. Në këtë projektkalendar janë parashikuar 3 seanca plenare, përkatësisht në datat:

7 mars 2019, (e enjte)

14 mars 2019, (e enjte)

21 mars 2019, (e enjte)

Të gjitha materialet i keni përpara, çfarë sugjerimesh keni për programin dhe kalendarin?

Taulant Balla – Mirëmëngjesi! Në lidhje me planifikimin e projektakteve për në seancat përkatëse, por duke u nisur nga kalendari, dita e enjte datë 7 mars përkon me një ditë të shënuar të mësuesve dhe data 14 mars përkon me pushimin zyrtar me “Ditën e verës”. Propozoj që seanca e datës 7 mars të zhvillohej më datë 5 mars me qëllim që, në ditën e mësuesit të gjithë deputetët të kenë mundësi të jenë në zonat e tyre përkatëse. Seanca e datës 14 të planifikohet për në datën 13 mars, pasi data 14 mars është ditë pushim zyrtar dhe seanca të zhvillohet një ditë përpara.

Ermonela Felaj – Faleminderit. Do të propozoja që projektligji “Për ratifikimin e letërmarrëveshjes ndryshuese të marrëveshjes së financimit, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Shoqatës Ndërkombëtare për Zhvillim (IDA), për projektin “Siguria e digave”, të ratifikuar me ligjin nr.9965, datë 24.7.2008”, të kalonte për dhënie mendimi edhe në komisionin për Sigurinë Kombëtare, jo thjesht për faktin që projekti mban emërtimin “Siguri e digave”, por është një çështje që qartësisht lidhet me sigurinë dhe në mënyrë direkt ose indirekte lidhet me Drejtorinë e Ergjencave Civile, që është një institucion që përgjigjet në komision të Sigurisë, duke qënëse është institucion varësie i Ministrisë së Mbrojtjes.

Senida Mesi – Mirëmëngjesi të gjithëve. Në lidhje me projektligjin “Për gjuetinë” që është propozim i tre deputetësh, dhe komisioni për Integrimin European është komision për dhënie mendimi, mungon pasqyra e përputhshmërisë që ne e kemi detyrim në lidhje me ligjet, kur në to bëhet fjalë për përafrim të legjislacionit me Bashkimin European. Nuk jam e qartë se si duhet të procedojmë në momentin kur është nisëm e deputetëve. Kur është nisëm dhe

propozim i Këshillit të Ministrave, sigurisht që Parlamenti ja ka kërkuar gjithmonë Këshillit të Ministrave tabelën e përputhshmërisë, kurse në rastin konkret mungon. Nuk e di nga eksperiencia Juaj e mëparshme si e keni zgjidhur një problem të tillë?

Gramoz Ruçi – Në raste të tilla nuk do i çohet Qeverisë. Ju keni një drejtor në Kuvend, që është drejtorja e Përafrimit të Legjislacionit në komisionin përkatës. Do t'i adresoheni zotit Dedë Kasneci, drejtorit të shërbimit, dhe Ai të përgatisë dhe të japë mendim komisionit për përputhshmërinë e nismës.

Milva Ekonomi – Mirëmëngjesi! Nuk kam një pyetje direkt për kalendarin, por kam pyetje të lidhur me kalendarin. Në komisionin e Edukimit dhe Mjeteve të Informimit Publik kemi diskutuar në parim një nisëm që ka ardhur nga Grupi Parlamentar i LSI-së, për ligjin e arsimit të lartë. Ndërkohë në komision në kalendarin e mëparshëm janë depozituar dy nisma që kanë ardhur nga deputetët e LSI-së, si duhet të veprohet në këtë rast, t'i përfshijmë në kalendar apo t'i lëmë

Taulant Balla – Zonja Ekonomi është deputete e re. Ju informoj se, të gjitha nismat të propozuara nga deputetë që kanë dhënë dorëheqjen nga mandati nuk qëndrojnë më dhe nuk janë pjesë e punës së Kuvendit. Rregullorja e Kuvendit dhe Kushtetuta e përcaktojnë qartë që, kur propozuesi nuk është më pjesë e parlamentit të gjitha këto projektakte të propozuara nga deputetë që nuk e gëzojnë më mandatin e deputetit, nuk janë më pjesë e shqyrtimit të punës së komisioneve dhe seancave plenare.

Vasilika Hysi – Faleminderit zoti Kryetar! Komisioni i Ligjeve ka përfunduar së miratuar Rezolutën “Për njohjen dhe mbështetjen e veprimtarisë së mbrojtësve të të drejtave të njeriut, në promovimin, nxitjen dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore, forcimin e shtetit të së drejtës dhe konsolidimin e demokracisë”. Nëse është e mundur do të sugjeroja të përfshihej në rendin e ditës që kemi këtë javë.

Gramoz Ruçi – Sugjerime të tjera në lidhje me programin dhe kalendarin! Nuk ka, atëherë biem dakord me çka u sugjerua nga kolegët. Të gjitha ndryshimet të reflektohen në kalendar. Për sa i përket datave të seancave, për datën 7 mars që përkon dhe me festën e mësuesit dhe kjo duhet respektuar.

Vë në vëmendjen Tuaj se, është paraqitur kërkesë nga Ambasadori i Sllovenisë, ku ka shprehur interes që Presidenti i Sllovenisë vijë në Parlament në datën 5 mars. Tradita jonë ka qenë se të gjithë presidentët kanë kaluar në Parlament, në këtë mënyrë të përputhet data e vizitës së Tij me datën e seancës plenare, datën 5 mars 2019. Gjithashtu mbetemi dakord për datën 14 mars që ta avancojë një ditë më përpara, pra në datën 13 mars dhe data 21 mars të mbetet siç është.

Njoftoj Konferencën e Kryetarëve se dje kam firmosur dhe kam nxjerrë urdhrin për thirrjen e seancës plenare, sot më datë 26 shkurt në orën 17.00.

Rendi i ditës i seancës plenare do të jetë i njëjtë me atë rend dite që ka pasur seanca e datës 21 shkurt, të cilën nuk e zhvilluam. Ndaj Ju lutem të njoftohen deputetët që të jenë në seancë, pavarësisht nga njoftimet që kanë marrë në rrugë elektronike.

MBLEDHJA MBYLLET